

Rekomandime për udhëtarët

- Udhëtoni me agjensi udhëtimit të besueshme.
- Kontrolloni a ju duhet siguracion shëndetësor nga lloji i tij (dokumenti/konfirmimi nga zyrat shëndetësore). Rekomandohet të pajiseni me siguracion shëndetësor përpara nisjes.
- Nëse udhëtoni drejt zonës Shengen me automjet, duhet të pajiseni me patentë ndërkombëtare drejtimi dhe me kartonin jeshil të siguracionit ndërkombëtar të makinave. Për më shumë informacion, përfshirë rregullat rrugore të BE-së, vizitoni faqen e internetit http://ec.europa.eu/transport/road_safety/observatory/traffic_rules_en.htm
- Numri i urgjencës është 112 dhe vlen për të gjitha shtetet anëtare të BE-së (për policinë, ambulancën dhe zjarrfikësin).

Në cilat Shtete mund të udhëtoni pa viza?

- Rregullat e reja zbatohen në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian përveç Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës. Qytetarët shqiptarë mund të udhëtojnë pa viza edhe në Islandë, Norvegji e Zvicër.

Austri	Finland	Letoni	Portugali
Belgjikë	Francë	Lituani	Rumani
Bullgari	Gjermani	Luksemburg	Slovaki
Qipro	Greqi	Maltë	Sloveni
Rep. Çeke	Hungari	Holandë	Spanjë
Danimark	Island	Norvegji	Suedi
Estoni	Itali	Poloni	Zvicër

Kujdes

- Mos rrezikoni duke kaluar dhe qëndruar në mënyrë të paligjshme në asnjë vend të Shengenit dhe të humbisni kështu mundësinë ligjore që ju mundëson liberalizimi i vizave për të lëvizur të lirë në të gjitha vendet Shengen.
- Çdo person që kapet duke hyrë apo duke qëndruar në mënyrë të paligjshme në njërin nga vendet e Shengenit do të kthehet menjëherë në Shqipëri dhe nga autoritetet e këtij vendi mund t'i ndalohet hyrja në të gjitha vendet Shengen deri për **5 vjet**. Ky është një standard që zbatohet sot për të gjithë dhe në të gjitha vendet e BE-së.
- Një numër i madh shtetasish të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë nuk po lejohen sot të hyjnë në asnjë nga vendet e Shengen-it dhe po kthehen në kufi pikërisht për këtë arsye.



MINISTRIA E BRENDSHME
www.moi.gov.al



Ministria e Brendshme

**LIBERALIZIMI
I VIZAVE**

**ÇFARË DUHET
TË DIMË...**